

BULETINI 3 - MUJOR



Vijon disbursimi i Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2025



Korrik - Shtator 2025

Kredia e Butë dhe Garancia Sovrane Aplikimet pranë bankave të nivelit të dytë, deri më 20 Nëntor 2025

SKEMA KOMBËTARE E INVESTIMEVE 2025

Në kuadër të hapjes së thirrjes për Skemën Kombëtare të Investimeve 2025, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural zhvilloi takime teknike në të gjitha qarqet e vendit. Këto takime patën si qëllim informimin e fermerëve, agropërpunuesve dhe sipërmarrësve ruralë mbi mundësitë e reja të mbështetjes financiare, si edhe shpjegimin e detajuar të kriterëve që duhen plotësuar për përfitim nga skema.

Skema Kombëtare e Investimeve 2025 ofron mbështetje financiare përmes nëntë masave, të cilat janë: Investimet në serra të reja diellore, mbjelljet e reja, rrjeta antibreshër, instalimi i sistemit të ujitjejes me pika, stalla blegtorale dhe stabilimente për rritjen e shpendëve, mekanizimin e bujqësisë, agropërpunim, agroturizëm dhe panele fotovoltaike, si edhe akuakulturë detare.

Përmes këtyre masave synohet modernizimi i bujqësisë, rritja e produktivitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale.





SEMINAR MBI MENAXHIMIN E RISKUT DHE PARANDALIMIN E PARREGULLSIVE NË KUADËR TË PROGRAMIT IPARD III

AZHBR, në bashkëpunim me DG AGRI dhe OLAF, organizoi seminarin mbi menaxhimin e riskut dhe parandalimin e parregullsisve të mundshme në zbatimin e programit IPARD III. Në aktivitet morën pjesë gjithashtu përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Shqipëri dhe të gjithë strukturave të përfshira në zbatimin e programit IPARD. Ky aktivitet shërbeu si një platformë e rëndësishme diskutimi për: Mekanizmat e kontrollit dhe raportimi; Praktikave më të mira për identifikimin dhe parandalimin e parregullsisve; Përdorimin e mjeteve teknologjike

për rritjen e transparencës dhe integritetit në menaxhimin e fondeve. Seminari krijoi një hapësirë të vlefshme për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive me ekspertët evropianë, duke forcuar angazhimin e përbashkët për një administrim të drejtë dhe të qëndrueshëm të fondeve të BE-së.

AZHBR mbetet e përkushtuar në sigurimin e një zbatimi transparent, efektiv dhe të qëndrueshëm të programeve të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural në vend.



AZHBR DHE ASIG ZHVILLOJNË TRAJNIME PËR EKIPIN E LPIS MBI PËRDORIMIN E GJEOPORTALIT KOMBËTAR

AZHBR, në bashkëpunim me ASIG, po organizon një cikël trajnimesh për ekipin e LPIS, me fokus zgjerimin e njohurive mbi Platformën e Gjeoportalit Kombëtar dhe mënyrat më efikase për vënien në dispozicion të të dhënave gjeohapësinore.

LPIS, si pjesë thelbësore e IACS, shërben për kontrollin e përdorimit të tokës dhe rritjen e transparencës, në përputhje me standardet e Politikës së Përbashkët Evropiane. Ky bashkëpunim synon forcimin e kapaciteteve për administrimin e të dhënave gjeohapësinore sipas praktikave më të mira evropiane.



KONFERENCË MBI SISTEMIN E INTEGRUAR TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT NË FRANCË



AZHBR mori pjesë në Konferencën e dytë të Shkëmbimit Komunitar (ICE) të organizuar nga Qendra Kërkimore e Komisionit Evropian, në bashkëpunim me DG AGRI dhe Agjencinë Franceze të Shërbimeve dhe Pagesave. Kjo konferencë shërben si një platformë ku shtetet anëtare ndajnë përvojat, praktikat më të mira dhe sfidat mbi zbatimin e IACS, një instrument thelbësor për realizimin e objektivave të Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP).



Pjesëmarrësit diskutuan mbi zgjidhjet inovative që lehtësojnë procedurat për fermerët, përmirësojnë cilësinë e zbatimit të CAP dhe prezantuan zhvillimet më të fundit nga kërkimet shkencore dhe sektori privat. Pjesëmarrja e AZHBR nënvizon angazhimin për të ndjekur praktikat më të mira evropiane dhe për t'i kthyer ato në mbështetje konkrete për fermerët në vend.

AZHBR NË KONFERENCËN E 24-TË TË AGJENCIVE TË PAGESAVE MBI INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË NË BUJQËSI

Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR, znj. Ardita kuçi, mori pjesë në Konferencën e 24-të të Agjencive të Pagesave të vendeve baltike dhe të BE-së, me temë "Inovacioni dhe Teknologjia – Çelësi për Zbatimin e Planit Strategjik të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2023–2027". Diskutimet u fokusuan tek përdorimi i inteligjencës artificiale dhe zgjidhjeve digjitale për mbështetjen e fermerëve dhe administrimin e programeve subvencionuese.



AZHBR prej një viti ka një marrëveshje bashkëpunimi me agjencinë homologe të Lituaniës, ku shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira është në fokus të veprimtarive të përbashkëta. Pjesëmarrja në këtë konferencë ishte një mundësi e vlefshme për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe për të sjellë ide të reja në zhvillimin rural në vend.



VIJON DISBURSIMI I SKEMËS KOMBËTARE TË MBËSHTETJES 2025

SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES NË BUJQËSI 2025

23,396

FERMERË TË MBËSHTETUR

#MASAT DIREKTE 

DERI MË 30 SHTATOR 2025

AZHBR vijon disbursimin e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2025. Deri më sot janë 23,396 fermerë të mbështetur me një fond prej 1,13 Miliard lekësh, ndërkohë po vijon intensivisht procesi për kryerjen e pagesave për fermerët e tjerë.

Në Skemën Kombëtare 2025 ofrohet mbështetje për: tufën bazë të matrikulluar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fara fidanë dhe inpute të tjera, bimët mjekësore - aromatike, fermat organike, certifikimi Global Gap, si edhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Qëllimi i këtyre masave është ulja e kostove për fermerët dhe rritja e rendimentit të prodhimit vendas.

KREDIA E BUTË DHE GARANCIA SOVRANE PËR BUJQËSINË

Kredia e Butë dhe Garancia Sovrane, dy instrumente që rrisin aksesin në financim për fermerët dhe agrobizneset: Kredia me normë interesi vetëm 2% dhe Garancia Sovrane që mbulon deri në 70% të kolateralit.

Këto instrumente nxisin dhe lehtësojnë realizimin e investimeve në bujqësi, duke përfshirë rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, mekanizimin, agropërpunimin, turizmin rural dhe akuakulturën.

Ndërsa Skema Kombëtare e Investimeve ofron 50% grant për 9 masa mbështetëse. Ndërthurja e këtyre mekanizmave siguron një mbështetje të plotë për realizimin e investimeve, duke synuar që bujqësia të bëhet një sektor fitimprurës, cilësor dhe konkurrues, si në tregun vendas ashtu edhe në atë të jashtëm.

Aplikimet për Kredinë e Butë me Garanci Sovrane kryhen pranë bankave të nivelit të dytë, deri më 20 nëntor 2025.

INSTRUMENTET E FINANCIMIT PËR BUJQËSINË

50% GRANT

SKEMA KOMBËTARE
E INVESTIMEVE



Paguani vetëm 50%
të investimit tuaj

KREDI E BUTË

NORMË
INTERESI 2%



Financim me normë
të ulët interesi

**GARANCI
SOVRANE**

MBULIM
KOLATERALI 70%



Sigurim i kredisë
me 70% kolateral

